

20140411154

LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR THEMELIMIN E RRJETIT HULUMTUES AKADEMIK MAQEDONAS

Neni 1

Në Ligjin për themelimin e Rrjetit Hulumtues Akademik Maqedonas të ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/10), në nenin 11 paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Për zgjedhjen e drejtorit publikohet shpallje publike në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase".

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Për drejtor mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion i kundërvajtjes ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- 3) ka së paku 240 kredi sipas EKTS ose të mbaruar shkallën VII/1 nga sfera e teknologjive informatike dhe komunikuese;
- 4) ka njohuri specialistike nga sfera e teknologjive informatike dhe telekomunikimit;
- 5) ka minimum pesë vjet përvojë pune nga sfera e teknologjive informatike dhe komunikuese;
- 6) posedon një nga këto certifikata të njohura ndërkombëtarisht ose vërtetime për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
- IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
- ELTS (IELTS) - Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
- FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të dhënë,
- Bulats (BULATS) - së paku 60 pikë ose
- APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2);
- 7) ka aftësi profesionale dhe organizuese;
- 8) të ofrojë Program më kualitativ për punën e MARnet dhe
- 9) ka dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet."

Neni 2

Drejtori i MARnet i zgjedhur deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdon ta kryejë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është zgjedhur.

Neni 3

Dispozitat e nenit 1 të këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me kushtin për njohjen e gjuhës së huaj do të fillojnë të zbatohet pas dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.